



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**MBI PROGRAMIN E BURSAVE PASUNIVERSITARE “EUGEN IONESCU”,  
VITI AKADEMIK 2015-2016**

Ministria e Punëve të Jashtme Rumune njofton se ka filluar procesi i aplikimit për programin e bursave “Eugen Ionescu” në doktoraturë dhe pas/doktoraturë për në Universitetet Publike të Rumanisë, për vitin 2015-2016.

Programi i bursave u drejtohet studentëve të doktoratës dhe kërkueseve nga shtetet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (ONF). Nga perspektiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme Rumune, prioritet kanë kandidatët që vijnë nga Evropa Qendrore dhe Lindore.

Kohëzgjatja e një burse së studimit varion nga 3 deri në 6 muaj në vartësi të zgjatjes së projektit kërkimor, duke filluar nga data 1 prill 2016. Ata duhet të kenë njohje shume të mirë të gjuhës frënge. Preferohen kandidatët që nuk e kalojnë moshën 40 vjeç.

Bursat akordohen përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rumanisë dhe administrohen nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (ONF).

Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë Agjencisë Universitare të Frankofonisë në Bukuresht (Agence Universitarie Francophonie) dokumentet sipas listës si vijon:

1. Formularin e aplikimit, i cili plotësohet online dhe në adresën:  
<https://formulaire.auf.org/>;
2. Curriculum Vitae, ku të përmenden botimet më të rëndësishme shkencore të aplikantit;
3. Listën e plotë e botimeve shkencore.
4. Kopjet e (rëndësishme) të botimeve shkencore të përshkruara më lart.
5. Titullin e studimit në doktoraturë. Kopje të certifikuar të diplomës për këtë nivel studimi;
6. Një përshkrim të hollësishëm në një ose dy faqe (maksimumi 1000 fjalë) të programit të studimit që kandidati dëshiron të studiojë në një fushë të caktuar në rast kërkimi;
7. Një fotokopje të faqes së pasaportës;
8. Certifikatë njohurie për gjuhën frënge;
9. 3 (tre) letra rekomandimi;
10. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
11. 4 fotografi 4 cm x 6 cm.

Procedura për këtë aplikim është si më poshtë vijon:

1. Të gjithë kandidatët, të cilët janë të interesuar për këtë aplikim, duhet të marrin miratimin nga 1 prej 26 universitetet rumune.
2. Dosja e plotësuar duhet të dorëzohet pranë zyrës qendrore të Agjencisë Universitare të Frankofonisë (AUF), së cilës i përket universiteti ku kandidati ka aplikuar dhe është pranuar;
3. Të gjitha dosjet e dorëzuara pranë zyrave rajonale përcillen zyrtarisht pranë zyrës rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore të AUF-së, me seli në Bukuresht.
4. Përzgjedhja e parë e kandidatëve bëhet nga një Komision Rajonal Ekspertësh, me dosje, në bazë të kriterëve shkencore që plotëson çdo kandidat.
5. Përzgjedhja përfundimtare e dosjeve bëhet edhe nga një komision tjetër i përbashkët, ku Ministria e punëve të Jashtme ka rolin kryesor në vendim marrje në përputhje me interesat dhe prioritetet e politikës së jashtme të vendit tonë.
6. Publikohet rezultati i procedurës dhe emri i ftuesve të bursës.

Për mënyrën e aplikimit dhe për informacionin përkatës, të interesuarit t'i referohen adresave sipas listës së universiteteve të përfshira në Programin e Bursave "Eugen Ionescu" dhe faqes së Internetit të Agjencisë Universitare të Frankofonisë në Bukuresht (Agence Universitaire Francophonie) në vijim:

[http://www.auf.org/bureau-europe-centrale-et-orientale/bourses\\_regionales/bourses-de-recherche-doctorale-et-de-post-doctorat/](http://www.auf.org/bureau-europe-centrale-et-orientale/bourses_regionales/bourses-de-recherche-doctorale-et-de-post-doctorat/)

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve pranë zyrës rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore të AUF-së është data **17 Janar 2016.**

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**